

THE COLLEGE BOARD

SAT Test Directions Translated into ALBANIAN for Students

Spring 2019 School Day Testing Only

Notes to the Proctor:

Your school may be offering both the SAT (no Essay) and SAT with Essay. The College Board now allows schools to combine students with both test options in a single standard room. This translated script includes a section of translated test directions for EL students testing in a combined room.

Printing this document for your students: These translated directions are grouped into several parts for students: Part 1 (Notes to Student), Part 2 (Standard SAT Script Through Math Test – No Calculator), Part 3 (Standard SAT Script: Math Test – Calculator and SAT Essay), and Part 4 (Combined Room SAT Standard Script: Math Test – Calculator and SAT Essay).

- If testing in a standard room that is UNCOMBINED, or in an accommodated room, print Parts 1–3. Omit Part 4.
- If testing in a standard room that is COMBINED, print Parts 1–2, and 4. Omit Part 3.

Using this document on test day:

Distribute this document once students are seated.

Students may use this document to read translations of the directions that are read aloud or printed in their test book.

Students may keep this document open and on their desk during the entire testing period.

Students may **not** be given additional time, unless approved by College Board as a separate accommodation.

Collect this document from each student at the end of testing and securely destroy it.

Pasqyra e lëndës

Notes to the Proctor:	1
1 Shënim për studentin	3
2 Teksti standard i SAT gjatë testit të matematikës – Pa makinë llogaritëse.....	4
2.1 Para fillimit të testit.....	4
2.2 Shpërndarja e fletëve të përgjigjeve	5
2.3 Shpërndarja e librave të testimit	7
2.4 Udhëzimet në kapakun e përparmë.....	9
2.5 Udhëzimet në kapakun e pasmë	10
2.6 Seksioni 1—Testi i të lexuarit.....	11
2.6.1 Në lidhje me pushimin.....	12
2.6.2 Seksioni 1 Udhëzimet në librin e testimit.....	12
2.7 Deklarata e përputhshmërisë	12
2.8 Seksioni 2—Testimi i shkrimit dhe i gjuhës	12
2.8.1 Seksioni 2 Udhëzimet në librin e testimit.....	13
2.9 Seksioni 3—Testi i matematikës – Pa makinë llogaritëse	14
2.9.1 Gjatë pushimit	15
2.9.2 Seksioni 3 Udhëzimet në librin e testimit.....	15
3 Teksti standard i SAT: Testi i matematikës me makinë llogaritëse dhe eseja e SAT....	17
3.1 Seksioni 4—Testi i matematikës – Me makinë llogaritëse	17
3.1.1 Gjatë pushimit	18
3.1.2 Seksioni 4 Udhëzimet në librin e testimit.....	19
3.2 Eseja SAT.....	21
3.2.1 Udhëzime për librin e esesë	22
3.3 Pas përfundimit të testimit	23
3.4 Plotësimi i fletëve të përgjigjeve	23
3.5 Mbledhja e fletëve të përgjigjeve.....	25
4 Teksti standard i SAT për sallat me studentë të kombinuar: Testi i matematikës me makinë llogaritëse dhe eseja e SAT	26
4.1 Seksioni 4—Testi i matematikës – Me makinë llogaritëse	26
4.1.1 Seksioni 4 Udhëzimet në librin e testimit.....	29
4.2 Plotësimi i marrësve të rezultateve.....	31
4.3 Mbledhja e fletëve të përgjigjeve.....	32
4.4 Eseja SAT.....	32
4.4.1 Udhëzime për librin e esesë	33
4.5 Para se të largohen studentët	34

1 Shënim për studentin

- Më poshtë është një përkthim i udhëzimeve që mbikëqyrësi do t'i lexojë me zë si edhe udhëzimet me shkrim që gjenden në librin e provimit. Ndiqeni atë ndërkohë që mbikëqyrësi lexon me zë udhëzimet në anglisht. Këto udhëzime të përkthyer mund të mos përputhen fjalë për fjalë me atë që do të lexojë mbikëqyrësi; sidoqoftë informacionet në thelb janë të njëjta. Nëse keni pyetje për atë që po lexon mbikëqyrësi, ju lutem ngrini dorën.
- Mbikëqyrësi mund t'i kapërcejë disa udhëzime që nuk zbatohen në situatën e provimit tuaj.
- Ky material mund të mbahet mbi bankë gjatë gjithë kohëzgjatjes së testit, por duhet t'i kthehet mbikëqyrësit në përfundim të tij.
- NUK lejohet ta përdorni këtë dokument për letër shënimesh.
- Në momente të ndryshme, mbikëqyrësi do të lajmërojë kohën e mbetur për pjesën e provimit, si edhe pushimet kur është e përshtatshme. Nëse po bëni provimin me një lehtësi të miratuar, këto lajmërimë mund të ndryshojnë nga oraret dhe pushimet e renditura në këtë dokument të përkthyer. Dëgjojini me kujdes komunikimet që ju lexon mbikëqyrësi
- Nëse po bëni provim me akomodimet e aprovuara, mbikëqyrësi mund t'ju japë udhëzime të mëtejshme në anglisht.
- Në këtë dokument janë përdorur ikona për të tërhequr vëmendjen tuaj tek informacione të caktuara:



Informacione të rëndësishme



Udhëzimet e dhëna nga mbikëqyrësi



Udhëzime që gjenden në librin e provimit

2 Teksti standard i SAT gjatë testit të matematikës – Pa makinë llogaritëse

2.1 Para fillimit të testit

Mbikëqyrësi do të fillojë duke thënë:



Mirëmëngjesi. Sot do të bëni provimin SAT. Kjo është mundësia të tregoni sa të përgatitur jeni për kolegji dhe karrierë.

Ju lutem, pyesni për çdo paqartësi në lidhje me udhëzimet që do t'ju jap, në mënyrë që të siguroheni për të dhënë më të mirën tuaj. Nëse po përdorni udhëzime të printuara që janë përkthyer, hapni tani broshurën për të më ndjekur ndërsa ju jap udhëzimet.

Pastaj mbikëqyrësi do të thotë:



College Board ka vendosur rregullore për t'i dhënë gjithsecilit prej jush mundësi të barabarta për të treguar aftësitë dhe njohuritë tuaja. Ne do të përjashtojmë dhe do të anulojmë rezultatet e kujtqdo që përpiqet të përfitojë në mënyrë të padrejtë nëse:

- Jep ose merr ndihmë të çfarëdo lloji në provim
- Shikon në librin e provimit para se të fillojë provimi
- Punon në pjesën e gabuar ose kërkon në një pjesë të mëparshme ose të mëvonshme në librin e provimit ose fletën e përgjigjeve
- Përdor makinë llogaritëse gjatë një seksioni në të cilin nuk lejohet përdorimi i saj (përveç nëse është autorizuar për raste të veçanta)
- Shënon përgjigje pasi ka mbaruar koha
- Ndan pyetjet ose përgjigjet e provimit me cilindo gjatë ose pas provimit
- Përdor mjete provimi të paautorizuara, duke përfshirë telefonat, gjatë provimit ose pushimeve
- Përpiqet të bëjë provimin në vend të dikujt tjetër

Nëse bëni ndonjë nga sa më sipër, mund t'ju ndalohet pjesëmarrja në testet e "College Board" në vijimësi.

Gjithashtu mund të përjashtoheni nëse:

- Hani ose pini gjatë provimit (përveç nëse kjo është miratuar si lehtësi - përndryshe, ngrënia dhe pirja lejohen vetëm gjatë pushimeve)
- Shkaktoni shqetësime të çfarëdo lloji ose shpërqendroni për studentët e tjerë
- Shkoni te dollapi juaj ose largoheni nga ndërtesa gjatë pushimeve

Keni kohë deri në orën 11:59 p.m. me orën lindore në ditën e katërt të javës nga momenti i mbarimit të provimit për të paraqitur një ankesë për ditën e provimit. Nëse shikoni ndonjë lloj sjelljeje që ju shqetëson, ju lutem njoftoni koordinatoren e provimit që do t'ju shpjegojë si të kontaktoni College Board. Ka ndonjë pyetje?

Nëse shkolla juaj i ka mbledhur sendet personale të studentëve, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Në këtë moment duhet të keni dorëzuar të gjithë telefonat ose çdo pajisje tjetër elektronike. Nëse dikush ka ende pajisje elektronike të çfarëdo lloji, ju lutem çaktivizoni të gjitha alarmet, fikini dhe m'i dorëzoni mua tani. Të gjitha do t'ju kthehen në fund të provimit.

Nëse shkolla juaj NUK i ka mbledhur sendet personale të studentëve, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Nëse keni ende telefona apo ndonjë pajisje tjetër elektronike, duhet të çaktivizoni çdo alarm, t'i fikni dhe t'i vendosni në një qese plastike apo në çantën e shpinës, të cilat do të lihen në anë të sallës deri në përfundim të testit. Nëse ju nevojitet qese plastike për të vendosur telefonin, ngrini dorën që t'ua sjell një.

Çdo pajisje elektronike që nuk është fikur dhe lënë mënjane mund të konfiskohet dhe përmbajtja e saj mund të kontrollohet si pjesë e një hetimi të hollësishëm. Në rast se celulari juaj bën zhurmë ndërkohë që ju jeni duke e mbajtur atë, do të përjashtoheni nga testimi.

Pastaj mbikëqyrësi do të thotë:

-  Nëse, duke nisur nga ky moment, ndonjë prej studentëve shihet me telefon, ai do të përjashtohet.

Pastaj mbikëqyrësi do të thotë:

-  Tani do të përgatitemi për të filluar provimin.
 - Hiqni çdo gjë nga banka përveç lapsave dhe makinës llogaritëse të pranueshme.
 - Nëse keni marrë makinë llogaritëse ose bateri rezervë, nxirrini dhe lëri në dyshe poshtë bankës.
 - Vendosni poshtë bankës çdo shishe uji dhe ushqimet. Nëse keni ende qese apo çanta në bankë, mbyllini dhe mbajini nën bankë deri në përfundim të testit.

Kur të gjithë studentët të jenë gati, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Tani do të shikoj rreth e qark për një moment për t'u siguruar nëse po përdorni makina llogaritëse të aprovuara.

Pastaj mbikëqyrësi do të thotë:

-  Nuk lejohet t'i ndani ose shkëmbeni makinat llogaritëse në asnjë moment. Vendoseni makinën llogaritëse poshtë bankës tani. Nuk do t'ju duhet deri në një pjesë të mëvonshme.

2.2 Shpërndarja e fletëve të përgjigjeve

Pasi të ketë shpërndarë fletët e përgjigjeve, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Këto janë fletët e përgjigjeve që do t'i përdorni për të shënuar përgjigjet tuaja në provim. Nëse po përdorni fletë përgjigjesh me shkronja të mëdha, lexoni udhëzimet në faqen e parë të fletës së përgjigjeve tani. Numrat e faqeve do të jenë ndryshe nga ato që lajmëroj unë, por numrat e fushave do të jenë njëloj si numrat e fushave që jap për të gjithë. Do t'i shënoni katrorët me një X në vend se të mbushni flluskat.

Pastaj, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Ju lutem kontrolloni për t'u siguruar që në fletën e përgjigjeve të jetë emri juaj zyrtar dhe datëlindja juaj e saktë. Nëse fleta e përgjigjeve tuaja ka një etiketë, sigurohuni që është e saktë. Ngrini dorën nëse nuk keni fletën e duhur të përgjigjeve ose nëse gjeni ndonjë gabim në etiketë.

Nëse plotësimi i fushave të domosdoshme ka përfunduar nga të gjithë, mbikëqyrësi do të kalojë në pjesën “Udhëzimet e shpërndarjes së librave të testimit” në faqen 7.

Nëse ju ose studentët e tjerë duhet të plotësoni fushat e kërkuara në fletën e përgjigjeve, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Nëse emri dhe të dhënat e tjera në fletën e përgjigjeve janë të sakta, qëndroni ulur në qetësi disa minuta ndërkohë që udhëzoj studentët e tjerë për plotësimin e fushave të domosdoshme në fletët e tyre të përgjigjeve.

Nëse shkolla juaj përdor etiketa me identifikim paraprak, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Nëse fleta juaj e përgjigjeve përmban një etiketë, kontrollojeni për t'u siguruar që të dhënat të jenë të sakta. Ngrini dorën nëse gjeni ndonjë gabim.

Për fushën 1, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Nëse fusha 1 është bosh, vendosni mbiemrin, emrin dhe inicialin e emrit të dytë (nëse keni). Shkruani hapësira, viza ose apostrofë nëse këto janë pjesë e emrit tuaj. Printoni shkronjat me të mëdha në kuti, pastaj plotësoni flluskat përkatëse. Sigurohuni që çdo shenjë të jetë e errët dhe të mbushë komplet flluskën. Ngrini kokën lart kur të keni mbaruar.

Për fushën 2, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Nëse fusha 2 është bosh dhe nëse ndiqni këtë shkollë, mbushni rrethin e alternativës “Po”. Të tjerët që nuk e ndjekin rregullisht këtë shkollë, duhet të mbushin rrethin e alternativës përkatëse. Ngrini dorën nëse nuk jeni të sigurt për alternativën që duhet të mbushni.

Për fushat 3 dhe 4, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Nëse fushat 3 dhe 4 janë bosh dhe nëse ju ndiqni këtë shkollë, shkruani me germa shtypi emrin e shkollës sonë, qytetit dhe shtetit në fushën 3; më pas shkruani kodin me 6 shifra të shkollës _____ në fushën 4 dhe mbushni rrathët e alternativave përkatëse. Ngrini kokën kur të keni mbaruar.

Ngrini dorën nëse nuk ndiqni këtë shkollë ose nëse jeni arsimuar në kushtet e shtëpisë. Unë do të vij t'ju jap kodin e duhur që do të vendoset në fushën 4.

Nëse jeni arsimuar në kushtet e shtëpisë, mbikëqyrësi do t'ju thotë të mbushni rrethin e alternativës “Jo, jam arsimuar në kushtet e shtëpisë” dhe të shkruani “970000” në fushën 4. Nëse ndiqni një shkollë tjetër, mbikëqyrësi do t'ju thotë të mbushni rrethin e alternativës “Jo, nuk është kjo shkolla që ndjek rregullisht” dhe më pas të plotësoni të dhënat për shkollën në fushën 3. Gjithashtu, ai do t'ju japë edhe kodin e shkollës që do të vendoset në fushën 4.

Për fushën 5, mbikëqyrësi do të thotë:

- Nëse fusha 5 është bosh, shkruani numrin e identifikimit të studentit dhe mbushni rrethin e alternativës përkatëse, duke filluar nga kolona e parë majtas. Nëse numri i identifikimit përmban germa, mos i përfshini ato. Vendosni vetëm numrat pa hapësira ndërmjet tyre. Nëse nuk e dini numrin tuaj të identifikimit të studentit, lëreni bosh fushën 5. Ngrini kokën lart kur të keni mbaruar.

Për fushën 6, mbikëqyrësi do të thotë:

- Nëse fusha 6 është bosh, mbushni rrethin e alternativës për nivelin tuaj aktual.

Për fushën 7, mbikëqyrësi do të thotë:

- Nëse fusha 7 është bosh, plotësoni të 3 pjesët e datëlindjes suaj. Çdo fushë me 2 shifra duhet të fillojë me zero nëse numri është më pak se 10. Plotësoni vetëm 2 shifrat e fundit të vitit tuaj të lindjes. Ngrini dorën nëse keni pyetje.

Për fushën 8, mbikëqyrësi do të thotë:

- Nëse fusha 8 është bosh, shënoni rrethin e alternativës së duhur.

Para se të shpërndajë librat e testimit, mbikëqyrësi do të thotë:

- Nëse keni fusha të tjera të paplotësuara në pjesën e fletës së përgjigjeve që nuk ka të bëjë me pyetjet e testit, do të keni mundësi t'i plotësoni në përfundim të tij.

2.3 Shpërndarja e librave të testimit

Kur të gjithë studentët të jenë gati, mbikëqyrësi do të thotë:

- Tani do të shpërndaj librat e provimit. Mos i hapni derisa t'ju them unë.

Për përkthimin e kapakut të përparmë, shikoni “Udhëzimet në kapakun e përparmë” në fund të këtij seksioni.

Pastaj mbikëqyrësi do të thotë:

- Kur të merrni librin e provimit, kthejeni mbrapsht dhe shkruani me shkronja shtypi mbiemrin, emrin dhe inicialin e emrit të mesëm nëse keni.
Më pas shkruani kodin e shkollës _____, emrin e shkollës _____ dhe numrin (ose emrin) e kësaj salle _____.

Për përkthimin e kapakut të pasmë, shikoni “Udhëzimet në kapakun e pasmë” në fund të këtij seksioni.

Pastaj mbikëqyrësi do të thotë:

- Tani lexoni kapakun e pasmë. Ka informacione të rëndësishme për shënimin e përgjigjeve dhe nxjerrjen e rezultateve. Kur të keni mbaruar së lexuari, ju lutem ngrini kokën.
A keni pyetje për ato që sapo lexuat?

Pasi t'u jeni përgjigjur të gjitha pyetjeve, mbikëqyrësi do të thotë:

- Udhëzimet e mëposhtme janë tepër të rëndësishme për rezultatet e provimit tuaj. Nëse nuk i ndiqni saktë udhëzimet e mia, mund të mos merrni rezultat. Dëgjoni me kujdes. Sigurohuni që të përdorni një laps grafiti nr. 2 dhe që t'i mbushni me ngjyrë të errët dhe plotësisht rrathët e alternativave në fletën e përgjigjeve. Nëse e ndryshoni përgjigjen, fshijeni sa më shumë të jetë e mundur. Mos bëni shkarravina dhe mos e përdorni fletën e përgjigjeve për shënime personale. Nuk lejohet të përdorni laps mekanik.

Për fushën A, "Form Code", mbikëqyrësi do të thotë:

- Në kapakun e pasmë të librit të testimit, gjeni fushën me emërtimin "Form Code". Kopjoni shkronjat dhe numrat e fushës A në pjesën e pasme të fletës së përgjigjeve saktësisht siç tregohet në pjesën e pasme të librit të provimit dhe plotësoni flluskat. Nëse po përdorni fletë përgjigjesh me shkronja të mëdha, kjo është në faqen 16.

Për fushën B, "Test ID", mbikëqyrësi do të thotë:

- Tani gjeni fushën me emërtimin "Test ID". Kopjoni numrin në fletën e përgjigjeve në fushën B.

Për fushën C, "Test Book Serial Number", mbikëqyrësi do të thotë:

- Shikoni në kapakun përpara të librit të provimit. Gjeni numrin në cepin e sipërm djathtas me emërtimin "Test Book Serial Number" dhe shkruajeni atë në fushën C të fletës së përgjigjeve. Mbushni flluskat përkatëse.

Për të gjithë studentët, mbikëqyrësi do të thotë:

- Merrni një moment për t'u siguruar që fushat Form Code, Test ID, dhe Numri i serisë së librit të provimit janë plotësuar saktë. Është e domosdoshme që të vendosni kodet e sakta në fletën e përgjigjeve. Përndryshe, mund të mos merrni rezultatet.

Nëse shkolla juaj përdor kode për sallën e testimit, mbikëqyrësi do të thotë:

- Në fushën D të fletës së përgjigjeve, plotësoni kodin me 3 shifra të sallës së testimit, që kam afishuar.

OSE

Nëse shkolla juaj NUK përdor kode për sallën e testimit, mbikëqyrësi do të thotë:

- Lëreni bosh fushën D në fletën e përgjigjeve.

Për fushën E, "Test Type", mbikëqyrësi do të thotë:

- Në fushën E, mbushni rrethin e alternativës së testit që po bëni sot, të cilin e kam afishuar në dërrasë. Ngrini dorën nëse nuk jeni të sigurt për testin që duhet të zgjidhni.

Për të gjithë studentët, mbikëqyrësi do të thotë:



Disa nga gjërat kryesore që duhet të mbani mend gjatë testimit janë: Nëse mbaroni para se të njoftohet mbarimi i kohës, mund të kontrolloni punën tuaj në këtë pjesë, por nuk lejohet të kaloni në asnjë pjesë tjetër. Mund ta përdorni librin e provimit për shënime, por përgjigjet duhet t'i shënoni në fletën e përgjigjeve përveç nëse aprovoheni t'i shënoni në librin e provimit. Pasi të jetë njoftuar mbarimi i kohës, nuk mundeni t'i kaloni përgjigjet nga libri i provimit në fletën e përgjigjeve ose të plotësoni flluskat bosh.

Gjatë provimit, mbajeni fletën e përgjigjeve dhe librin e provimit shtrirë në mes të bankës. Nëse gjeni ndonjë gabim me fletën e përgjigjeve ose librin e provimit, si për shembull mungesën e një faqeje, ose nëse shikoni se keni shkruar përgjigjet në pjesën e gabuar të fletës së përgjigjeve, ngrini dorën.

Së fundi, fletët e përgjigjeve dhe librat e provimit nuk duhet të hiqen asnjëherë nga dhoma e provimit.

Unë do të sillem nëpër sallë për të kontrolluar ecurinë tuaj. Unë do të mbaj gjithashtu orën zyrtare për provimin. Do të keni pushime gjatë provimit, kur mund të largoheni nga kjo sallë për të ngrënë diçka ose për të përdorur banjën.

Mos harroni, pasi të ketë mbaruar provimi, askush nuk mund të largohet nga dhoma derisa t'ju jap leje. Nëse keni pyetje rreth procedurave të provimit, ju lutem bëjini tani. Nuk mund t'i përgjigjem pyetjeve gjatë pjesëve me kohë të provimit.

2.4 Udhëzimet në kapakun e përparmë



Më poshtë është një përkthimi i kapakut të parmë të librit të provimit.

PËRKUJTUES TË RËNDËSISHËM

1

Është i nevojshëm një laps nr. 2 për provimin.
Mos përdorni laps mekanik ose stilolaps.

2

Ndarja e pyetjeve me cilindo është shkelje e politikave për sigurinë dhe drejtësinë e provimit dhe mund të bëjë që rezultatet tuaja të anulohen.

KY LIBËR PROVIMI NUK DUHET TË MERRET JASHTË SALLËS. NDALOHET RIPRODHIMI OSE PËRDORIMI I PAAUTORIZUAR I ÇFARËDO PJESE TË KËTIJ LIBRI PROVIMI.

© 2018 The College Board. College Board, SAT dhe logoja e lendes janë marka tregtare të regjistruara të College Board.

2.6 Seksioni 1—Testi i të lexuarit



*Koha standarde për pjesën 1 është **65 minuta**, me një **pushim 10-minutësh** në fund të pjesës. Nëse po bëni provimin me një lehtësi të miratuar, koha dhe pushimet mund të jenë ndryshe. Dëgjojeni me kujdes komunikimet që ju lexon mbikëqyrësi*

Përkthimi i udhëzimeve të librit të provimit shfaqet pas udhëzimeve të përkthyer me gojë.

Kur të gjithë studentët të jenë gati, mbikëqyrësi do të thotë:



Pasi të fillojmë, do të keni 65 minuta kohë për të punuar me pjesën 1, testin e leximit. Do të bëjmë një pushim të shkurtër kur të mbarojë kjo pjesë. Mos e hapni librin e testimit derisa t'ju them unë. Ju lutem mbani makinën llogaritëse poshtë bankës; nuk do t'ju duhet për këtë pjesë.

Sigurohuni që të përdorni një laps grafiti nr. 2 dhe që ta mbushni me ngjyrë të errët dhe plotësisht rrethin e alternativës për përgjigjen tuaj. Nëse e ndryshoni përgjigjen, fshijeni sa më shumë të jetë e mundur.

Mos harroni se merrni pikë për përgjigjet e sakta por nuk humbisni pikë për përgjigjet e gabuara. Kjo do të thotë se duhet të përpiqeni t'i përgjigjeni çdo pyetjeje edhe nëse nuk jeni i sigurt për përgjigjen e saktë.

Gjeni seksionin 1 në fletën e përgjigjeve. Sigurohuni të shënoni përgjigjet tuaja në hapësirat me numra që përkasin me pyetjet e provimit me numra në pjesën 1. Hapni librin e provimit në pjesën 1, lexoni udhëzimet dhe filloni punën. Koha fillon tani. Suksese.

Pas 30 minutash, mbikëqyrësi do të thotë:



Keni 35 minuta të mbetura në këtë pjesë.

Pas 60 minutash, mbikëqyrësi do të thotë:



Keni 5 minuta të mbetura në këtë pjesë.

Pas saktësisht 65 minutash, mbikëqyrësi do të thotë:



Ndaloni punën dhe lini lapsin poshtë. Mbyllni fletën e përgjigjeve dhe vendoseni brenda kapakut të parmë të librit të provimit. Mbylleni librin e provimit dhe lëreni mbi bankë. Tani do të bëjmë një pushim 10 minutësh.

Përdorimi i telefonit apo pajisjeve të tjera elektronike nuk lejohet gjatë asnjë prej pushimeve. Nëse keni marrë me vete diçka për të ngrënë, mund ta hani vetëm në vendet e caktuara. Mos shkoni në asnjë vend tjetër përveçse në vendet e caktuara, në korridor ose në banjë. Mos flisni në korridor ose mos diskutoni pyetjet e provimit me asnjë. Tregoni konsideratë për ata që janë në dhomat e tjera.

Do të fillojmë provimin përsëri pas saktësisht 10 minutash.

2.6.1 Në lidhje me pushimin

Në fund të pushimit, mbikëqyrësi do të thotë:



Ju lutem uluni.

2.6.2 Seksioni 1 Udhëzimet në librin e testimit



Më poshtë keni një përkthim të udhëzimeve që gjenden në fillim të pjesës 1 të librit të provimit.

65 MINUTA, 52 PYETJE (KOHA STANDARDE)

Kthehuni te pjesa 1 në fletën e përgjigjeve për t'iu përgjigjur pyetjeve në këtë pjesë.

UDHËZIME

Pas çdo fragmenti ose çifti fragmentesh më poshtë ka një numër pyetjesh. Pasi të keni lexuar çdo fragment ose çift fragmentesh, zgjidhni përgjigjen më të mirë për t'iu përgjigjur pyetjes duke u bazuar në atë çka është thënë ose nënkuptuar në fragment ose fragmente dhe në çdo grafik të shoqëruar (si tabelë ose diagram).

2.7 Deklarata e përputhshmërisë

Kur të gjithë studentët të jenë gati, mbikëqyrësi do të thotë:



Kur të jepni fletën e përgjigjeve tuaja, ju pranoni se, në asnjë rrethanë, nuk do të merrni me vete pyetjet e provimit nga dhoma e provimit, nuk do t'ia jepni askujt, ose nuk do t'i diskutoni me asnjë lloj forme, përfshirë por jo vetëm, me email, mesazhe ose internet. Këto kushte janë saktësuar në “SAT School Day Student Guide” (Udhëzuesi i studentëve për ditën e testimit SAT në shkollë) dhe në internet në adresën sat.org.

Nxirrni fletën e përgjigjeve, por lëreni librin e provimit të mbyllur. Kthejeni mbrapa fletën e përgjigjeve dhe gjeni fushën “Certification Statement”. Pasi të keni lexuar paragrafin e termave në fund, kopjoni deklaratën me shkrimin tuaj të zakonshëm - shkronjat e shtypit ose kursive janë të pranueshme gjithashtu. Pastaj shkruani emrin tuaj të plotë siç do të bënit në një dokument zyrtar. Pas firmës suaj, vendosni datën e sotme. Ngrini kokën kur të keni mbaruar.

Më poshtë është një përkthim i deklaratës së certifikimit në pjesën e pasme të fletës së përgjigjeve. Kopjoni pjesën në anglisht të deklaratës dhe jo përkthimin më poshtë:

Konfirmoj se unë jam personi i renditur në fletën e përgjigjeve dhe zotohem të ndjek politikën për sigurinë dhe drejtësinë e provimit siç përshkruhet në udhëzimet e provimit.

2.8 Seksioni 2—Testimi i shkrimit dhe i gjuhës



*Koha standarde për pjesën 2 është **35 minuta**. Nëse po bëni provimin me një lehtësi të miratuar, koha dhe pushimet mund të jenë ndryshe. Dëgjojeni me kujdes komunikimet që ju lexon mbikëqyrësi*

Përkthimi i udhëzimeve të librit të provimit shfaqet pas udhëzimeve të përkthyer me gojë.

Kur të gjithë të jenë gati, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Pasi të fillojmë, do të keni 35 minuta kohë të punoni me pjesën 2, testin e shkrimit dhe gjuhës. Nëse mbaroni para se të njoftohet mbarimi i kohës, mund të kontrolloni punën tuaj në këtë pjesë, por nuk lejohet të kaloni në asnjë pjesë tjetër. Ju lutem mbani makinën llogaritëse poshtë bankës; nuk do t'ju duhet për këtë pjesë.

Mbajeni fletën e përgjigjeve dhe librin e provimit të shtrirë mbi bankë.

Tani, gjeni pjesën 2 në fletën e përgjigjeve. Sigurohuni të shënoni përgjigjet tuaja në hapësirat me numra që përkasin me pyetjet e provimit me numra në pjesën 2. Hapni librin e provimit në pjesën 2, lexoni udhëzimet dhe filloni punën. Koha fillon tani.

Pas 15 minutash, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Keni 20 minuta të mbetura në këtë pjesë.

Pas 30 minutash, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Keni 5 minuta të mbetura në këtë pjesë.

Pas saktësisht 35 minutash, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Ndaloni punën dhe lini lapsin poshtë.

Vendosni fletën e përgjigjeve tuaja mbi faqen në librin e provimit ku keni ndaluar punën. Mbylleni librin e provimit.

2.8.1 Seksioni 2 Udhëzimet në librin e testimit



Më poshtë keni një përkthim të udhëzimeve që gjenden në fillim të pjesës 2 të librit të provimit.

35 MINUTA, 44 PYETJE (KOHA STANDARDE)

Kthehuni te pjesa 2 në fletën e përgjigjeve për t'iu përgjigjur pyetjeve në këtë pjesë.

UDHËZIME

Çdo fragment më poshtë shoqërohet nga një numër pyetjesh. Për disa pyetje, do të mendoni si mund të ndryshohet fragmenti për të përmirësuar shprehjen e ideve. Për pyetje të tjera, do të mendoni si mund të redaktohet fragmenti për të korrigjuar gabimet në strukturën, përdorimin ose shenjat e pikësimit të fjalive. Një fragment ose një pyetje mund të shoqërohet me një ose më shumë grafikë (si për shembull tabelë ose diagram) të cilat do t'i merrni parasysh ndërsa merrni vendime për ndërhyrje dhe redaksime.

Disa pyetje do t'ju drejtojnë te një pjesë e nënvizuar e një fragmenti. Pyetje të tjera do t'ju drejtojnë në një vend në fragment ose do t'ju kërkojnë të mendoheni për të gjithë fragmentin.

Pasi të keni lexuar çdo fragment, zgjidhni përgjigjen për t'iu përgjigjur pyetjes që përmirëson më së miri cilësinë e shkrimit në fragment ose që e bën fragmentin të përputhet me rregullat e gjuhës angleze të shkruar standarde. Shumë pyetje mund të kenë një opsion «ASNJË NDRYSHIM». Zgjidhni atë opsion nëse mendoni se zgjedhja më e mirë është ta lini siç është pjesën përkatëse të fragmentit.

2.9 Seksioni 3—Testi i matematikës – Pa makinë llogaritëse



Koha standarde për seksionin 3 është **25 minuta**, me një **pushim prej 5 minutash** në fund të tij. Nëse po bëni provimin me një lehtësi të miratuar, koha dhe pushimet mund të jenë ndryshe. Dëgjojeni me kujdes komunikimet që ju lexon mbikëqyrësi.

Përkthimi i udhëzimeve të librit të provimit shfaqet pas udhëzimeve të përkthyer me gojë.

Kur të gjithë studentët të jenë gati, mbikëqyrësi do të thotë:



Pasi të fillojmë, do të keni 25 minuta kohë të punoni me pjesën 3, testin e matematikës pa makinë llogaritëse. Do të bëjmë një pushim të shkurtër kur të ketë mbaruar kjo pjesë.

Megjithëse kjo është një pjesë matematike, nuk lejohet të përdorni makinë llogaritëse në këtë pjesë të provimit dhe makinën llogaritëse duhet ta mbani poshtë bankës përveç nëse keni një lehtësi të miratuar për të përdorur një makinë llogaritëse me katër funksione. Ka ndonjë pyetje?

Udhëzimet në lidhje me mënyrën e paraqitjes së përgjigjeve për pyetjet me emërtimin “Student-Produced Responses” (Përgjigjet e studentit), i gjeni në librin e testimit. Përgjigjet e këtyre pyetjeve mund të përmbajnë deri në 4 karaktere. Sigurohuni të shënoni përgjigjet tuaja në hapësirat me numra që përkasin me pyetjet e provimit me numra në pjesën 3.

Nëse mbaroni para se të njoftohet mbarimi i kohës, mund të kontrolloni punën tuaj në këtë pjesë, por nuk lejohet të kaloni në asnjë pjesë tjetër.

Ju lutem hapni librin e provimit dhe nxirrni fletën e përgjigjeve. Mbajeni fletën e përgjigjeve dhe librin e provimit të shtrirë mbi bankë. Gjeni pjesën 3 në fletën e përgjigjeve. Tani, kaloni në pjesën 3 të librit të provimit, lexoni udhëzimet dhe filloni punën. Koha fillon tani.

Pas 10 minutash, mbikëqyrësi do të thotë:



Keni 15 minuta të mbetura në këtë pjesë.

Pas 20 minutash, mbikëqyrësi do të thotë:



Keni 5 minuta të mbetura në këtë pjesë.

Pas saktësisht 25 minutash, mbikëqyrësi do të thotë:



Ndaloni punën dhe lini lapsin poshtë.

Vendosni fletën e përgjigjeve tuaja mbi faqen në librin e provimit ku keni ndaluar punën. Mbylleni librin e provimit dhe lëreni mbi bankë. Tani do të bëjmë një pushim për 5 minuta. Nëse keni marrë me vete diçka për të ngrënë, mund ta hani vetëm në vendet e caktuara. Njëllonj si më parë, mos shkoni në asnjë vend tjetër përveçse në vendet e caktuara, në korridor ose në banjë. Mos flisni në korridor ose mos diskutoni pyetjet e provimit me asnjë. Tregoni konsideratë për ata që janë në dhomat e tjera. Do të fillojmë provimin përsëri pas saktësisht 5 minutash.

2.9.1 Gjatë pushimit

Në fund të pushimit, mbikëqyrësi do të thotë:



Ju lutem uluni.

2.9.2 Seksioni 3 Udhëzimet në librin e testimit



Më poshtë keni një përkthim të udhëzimeve që gjenden në fillim të pjesës 3 të librit të provimit.

25 MINUTA, 20 PYETJE (KOHA STANDARDE)

Kthehuni te pjesa 3 në fletën e përgjigjeve për t'iu përgjigjur pyetjeve në këtë pjesë.


UDHËZIME

Për pyetjet 1-15, zgjidhni çdo problem, zgjidhni përgjigjen më të mirë nga alternativat e dhëna dhe mbushni filluskën përkatëse në fletën e përgjigjeve. Për pyetjet 16-20, zgjidhni problemin dhe vendosni përgjigjen tuaj në tabelë në fletën e përgjigjeve. Ju lutem shikoni udhëzimet para pyetjes 16 se si të vendosni përgjigjet tuaja në tabelë. Mund të përdorni çdo hapësirë në dispozicion në librin e provimit për shënime personale.


SHËNIME

1. Nuk lejohet përdorimi i një makine llogaritëse.
2. Të gjitha ndryshoret dhe shprehjet e përdorura tregojnë numra realë përveç nëse tregohet ndryshe.
3. Figurat e dhëna në këtë provim janë vizatuar në raporte proporcionale përveç nëse tregohet ndryshe.
4. Të gjitha figurat janë vendosur në plan të rrafshët përveç nëse tregohet ndryshe.
5. Përveç nëse tregohet ndryshe, domeini i një funksioni të dhënë f është seti i të gjithë numrave realë x për të cilin $f(x)$ është një numër real.


REFERENCE




$$A = \pi r^2$$
$$C = 2\pi r$$




$$A = \ell w$$





$$A = \frac{1}{2}bh$$




$$c^2 = a^2 + b^2$$



Trekëndësja kënddrejtë
të posaçëm




$$V = \ell wh$$




$$V = \pi r^2 h$$



$$V = \frac{4}{3}\pi r^3$$



$$V = \frac{1}{3}\pi r^2 h$$



$$V = \frac{1}{3}\ell wh$$

Numri i gradëve të harkut në një rreth është 360.

Numri i radianëve të harkut në një rreth është 2π .

Shuma e matjeve në gradë e këndeve të një trekëndëshi është 180.

UDHËZIME

Për pyetjet 16-20, zgjidhni problemin dhe vendosni përgjigjen tuaj në tabelën e fletës së përgjigjeve, siç përshkruhet më poshtë

1. Megjithëse nuk është e detyrueshme, sugjerohet që përgjigjja të shkruhet në kutitë në pjesën e sipërme të kolonave për t'ju ndihmuar t'i mbushni saktë rrathët e alternativave. Do merrni pikë vetëm nëse flluskat janë mbushur saktë.
2. Shënoni jo më shumë se një flluskë në çdo kolonë.
3. Asnjë pyetje nuk ka përgjigje negative.
4. Disa probleme mund të kenë më shumë se një përgjigje të saktë. Në këto raste, shënoni vetëm një përgjigje.

5. Numrat e përzierë të tillë si $3\frac{1}{2}$ duhet të paraqiten si 3.5 ose $7/2$. (Nëse forma

e paraqitjes në tabelë është

numri do të interpretohet si $\frac{31}{2}$, jo $3\frac{1}{2}$.)

6. **Përgjigjet dhjetore:** Nëse merrni një përgjigje dhjetore me më shumë shifra nga sa mund të mbajë tabela, mund të rrumbullakoset ose shkurtohet, por duhet të mbushë të gjithë tabelën.

Përgjigjja: $\frac{7}{12}$

Shkruajeni
përgjigjen →
nëpër kuti.

Vendosni
në tabelë
rezultatit.

← Vija e
thyesës

Përgjigjja: 2.5

Pika
— dhjetore

Mënyrat e pranueshme të paraqitjes së $\frac{2}{3}$ janë:

	2	/	3
			
			
			
			
			
			
			
			
			
			

.	6	6	6

.	6	6	7
	/	/	
	.	.	.
	0	0	0
(1)	(1)	(1)	(1)
(2)	(2)	(2)	(2)
(3)	(3)	(3)	(3)
(4)	(4)	(4)	(4)
(5)	(5)	(5)	(5)
(6)			(6)
(7)	(7)	(7)	
(8)	(8)	(8)	(8)

Përgjigjja: 201 – secili nga pozicionet është i saktë

	2	0	1

2	0	1	
	1	1	
0	0	0	0
		0	0
1	1		1
	2	2	2
3	3	3	3

SHËNIM:
Mund t'i filloni
përgjigjet tuaja në
cilëndo kolonë nëse
jua lejon hapësira.
Kolonat që nuk ju
duhet t'i përdorni
duhet të lihen bosh.

3 Teksti standard i SAT: Testi i matematikës me makinë llogaritëse dhe eseja e SAT

3.1 Seksioni 4—Testi i matematikës – Me makinë llogaritëse



*Koha standarde për pjesën 4 është **55 minuta**. Nëse po bëni provimin me një lehtësi të miratuar, koha dhe pushimet mund të jenë ndryshe. Dëgjojeni me kujdes komunikimet që ju lexon mbikëqyrësi*

Përkthimi i udhëzimeve të librit të provimit shfaqet pas udhëzimeve të përkthyer me gojë.

Kur të gjithë studentët të jenë gati, mbikëqyrësi do të thotë:



Pasi të fillojmë, do të keni 55 minuta kohë të punoni me pjesën 4, testin e matematikës me makinë llogaritëse.

Mund të përdorni një makinë llogaritëse për këtë pjesë. Ju lutem nxirrni makinën llogaritëse tani dhe vendoseni në mes të bankës.

Kur të përdorni makinën llogaritëse, ndiqni këto udhëzime:

- Mbajeni mbi bankë ose mbajeni në mënyrë të tillë që studentët e tjerë të mos shohin dot punën tuaj.
- Mos e ndani ose mos e shkëmbeni makinën llogaritëse.
- Nëse keni marrë makinë llogaritëse ose bateri rezervë, mbajini në dyshe poshtë bankës tuaj.
- Nëse makina juaj llogaritëse prishet dhe keni bateri ose makinë llogaritëse rezervë, ngrini dorën. Do të shikoj nëse mjeti juaj zëvendës është i pranueshëm. Nëse nuk keni rezervë, vazhdoni me provimin. Të gjitha pyetjetve të matematikës mund t'u jepet përgjigje edhe pa makinë llogaritëse.

Udhëzimet në lidhje me mënyrën e paraqitjes së përgjigjeve për pyetjet me emërtimin “Student-Produced Responses” (Përgjigjet e studentit), i gjeni në librin e testimit. Përgjigjet e këtyre pyetjeve mund të përmbajnë deri në 4 karaktere. Sigurohuni të shënoni përgjigjet tuaja në hapësirat me numra që përkasën me pyetjet e provimit me numra në pjesën 4.

Nëse mbaroni para se të njoftohet mbarimi i kohës, mund të kontrolloni punën tuaj në këtë pjesë, por nuk lejohet të kaloni në asnjë pjesë tjetër.

Ju lutem hapni librin e provimit dhe nxirrni fletën e përgjigjeve. Mbajeni fletën e përgjigjeve dhe librin e provimit të shtrirë mbi bankë. Gjeni pjesën 4 në fletën e përgjigjeve. Tani, kaloni në pjesën 4 të librit të provimit, lexoni udhëzimet dhe filloni punën. Koha fillon tani.

Pas 25 minutash, mbikëqyrësi do të thotë:



Keni 30 minuta të mbetura në këtë pjesë.

Pas 50 minutash, mbikëqyrësi do të thotë:



Keni 5 minuta të mbetura në këtë pjesë.

Pas saktësisht 55 minutash, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Ndalon punën dhe lini lapsin poshtë. Mbylleni librin e provimit dhe fletën e përgjigjeve. Vendoseni fletën e përgjigjeve ngjitur me librin e provimit.

Tani mbikëqyrësi do të thotë:

-  Para se të mbledh materialet e testit, ktheheni përmbys fletën e përgjigjeve (ose kthehuni në faqen 16 nëse po përdorni fletë përgjigjesh me kuadrate të zmadhuara) dhe verifikoni nëse e keni plotësuar kodin e formularit në fushën A. Ky kod është i nevojshëm për llogaritjen e rezultatit të testit tuaj.

Verifikoni gjithashtu nëse i keni plotësuar fushat B–E. Ju lutem, ngrini dorën nëse ju duhet ndihmë për plotësimin e ndonjë fushe.

3.1.1 Gjatë pushimit

Nëse po bëni versionin pa ese të SAT, mbikëqyrësi do të kalojë në pjesën “Pas përfundimit të testimit”.

Pasi të mbledhë dhe numërojë librat e testimit, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Vendoseni makinën llogaritëse poshtë bankës. Tani do të bëjmë një pushim për t’u çlodhur për 2 minuta. Nuk lejohet të largoheni nga dhoma apo të diskutoni pyetjet e provimit.

Në fund të pushimit, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Ju lutem uluni.

3.1.2 Seksioni 4 Udhëzimet në librin e testimit



Më poshtë keni një përkthim të udhëzimeve që gjenden në fillim të pjesës 4 të librit të provimit.

55 MINUTA, 38 PYETJE (KOHA STANDARDE)

Kthehuni te pjesa 4 në fletën e përgjigjeve për t'iu përgjigjur pyetjeve në këtë pjesë.


UDHËZIME

Për pyetjet 1-30, zgjidhni çdo problem, zgjidhni përgjigjen më të mirë nga alternativat e dhëna dhe mbushni filluskën përkatëse në fletën e përgjigjeve. Për pyetjet 31-38, zgjidhni problemin dhe vendosni përgjigjen tuaj në tabelë në fletën e përgjigjeve. Ju lutem shikoni udhëzimet para pyetjes 22 se si të vendosni përgjigjet tuaja në tabelë. Mund të përdorni çdo hapësirë në dispozicion në librin e provimit për shënime personale.


SHËNIME

1. Lejohet përdorimi i makinës llogaritëse.
2. Të gjitha ndryshoret dhe shprehjet e përdorura tregojnë numra realë përveç nëse tregohet ndryshe.
3. Figurat e dhëna në këtë provim janë vizatuar në raporte proporcionale përveç nëse tregohet ndryshe.
4. Të gjitha figurat janë vendosur në plan të rrafshët përveç nëse tregohet ndryshe.
5. Përveç nëse tregohet ndryshe, integrali i një funksioni të dhënë f është grupi i të gjithë numrave realë x për të cilët $f(x)$ është një numër real.


REFERENCE




$$A = \pi r^2$$
$$C = 2\pi r$$





$$A = \ell w$$




$$A = \frac{1}{2}bh$$




$$c^2 = a^2 + b^2$$




Trekëndësja kënddrejtë
të posaçëm




$$V = \ell wh$$




$$V = \pi r^2 h$$



$$V = \frac{4}{3}\pi r^3$$



$$V = \frac{1}{3}\pi r^2 h$$



$$V = \frac{1}{3}\ell wh$$

Numri i gradëve të harkut në një rreth është 360.

Numri i radianëve të harkut në një rreth është 2π .

Shuma e matjeve në gradë e këndeve të një trekëndëshi është 180.

UDHËZIME

Për pyetjet 31-38, zgjidhni problemin dhe vendosni përgjigjen tuaj në tabelën e fletës së përgjigjeve, siç përshkruhet më poshtë

1. Megjithëse nuk është e detyrueshme, sugjerohet që përgjigjja të shkruhet në kutitë në pjesën e sipërme të kolonave për t'ju ndihmuar t'i mbushni saktë rrathët e alternativave. Do merrni pikë vetëm nëse flluskat janë mbushur saktë.
2. Shënoni jo më shumë se një flluskë në çdo kolonë.
3. Asnjë pyetje nuk ka përgjigje negative.
4. Disa probleme mund të kenë më shumë se një përgjigje të saktë. Në këto raste, shënoni vetëm një përgjigje.
5. **Numrat e përzierë** të tillë si $3\frac{1}{2}$ duhet të paraqiten si 3.5 ose $\frac{7}{2}$. (Nëse forma

3	1	/	2
			
			

e paraqitjes në tabelë është

numri do të interpretohet si $\frac{31}{2}$, jo $3\frac{1}{2}$.)

6. **Përgjigjet dhjetore:** Nëse merrni një përgjigje dhjetore me më shumë shifra nga sa mund të mbajë tabela, mund të rumbullakoset ose shkurtohet, por duhet të mbushë të gjithë tabelën.

Përgjigjja: $\frac{7}{12}$

Shkruajeni
përgjigjen →
nëpër kuti.

Vendosni
në tabelë
rezultatit.

7	/	1	2
*	*	/	*
	0	0	0
1	1		1
2	2	2	
3	3	3	3
4	4	4	4
5	5	5	5
6	6	6	6
	7	7	7
8	8	8	8
9	9	9	9

← Vija e
thyesës

Përgjigjja: 2.5

Pika
— dhjetore

	2	.	5
•	/	/	
	0	0	0
1	1	1	1
2		2	2
3	3	3	3
4	4	4	4
5	5	5	
6	6	6	6
7	7	7	7
8	8	8	8
9	9	9	9

Mënyrat e pranueshme të paraqitjes së $\frac{2}{3}$ janë:

	2	/	3
			
			
			
			
			
			
			
			
			
			

.	6	6	6
	/	/	
	.	.	.
	0	0	0
1	1	1	1
2	2	2	2
3	3	3	3
4	4	4	4
5	5	5	5
6			
7	7	7	7
8	8	8	8

.	6	6	7
	0	0	0
1	1	1	1
2	2	2	2
3	3	3	3
4	4	4	4
5	5	5	5
6			6
7	7	7	
8	8	8	8

Përgjigjja: 201 – secili nga pozicionet është i saktë

	2	0	1

2	0	1	
	/	/	
○	○	○	○
	●	0	0
1	1	●	1
●	2	2	2
3	3	3	3

SHËNIM:
Mund t'i filloni
përgjigjet tuaja në
cilëndo kolonë nëse
jua lejon hapësira.
Kolonat që nuk ju
duhet t'i përdorni
duhet të lihen bosh.

3.2 Eseja SAT



Koha standarde për pjesën Eseja SAT është **50 minuta**. Nëse po bëni provimin me një lehtësi të miratuar, koha dhe pushimet mund të jenë ndryshe. Dëgjojeni me kujdes komunikimet që ju lexon mbikëqyrësi

Një përkthim i deklaratës për përdorimin e esesë suaj (në fletën e përgjigjeve) dhe i udhëzimeve të librit të esesë shfaqet pas udhëzimeve të përkthyer me gojë.

Për të gjithë studentët, mbikëqyrësi do të thotë:



Tani do t'i jap një libër eseje secilit prej jush. Mos e hapni librin e esesë derisa t'ju them unë.

Pastaj mbikëqyrësi do të thotë:



Kur të merrni librin e esesë, kthejeni mbrapa dhe shkruani me shkronja shtypi mbiemrin, emrin dhe inicialin e emrit të mesëm nëse keni. Më pas shkruani numrin e kodit të shkollës _____, emrin e shkollës _____ dhe numrin (ose emrin) e kësaj salle _____.

Pastaj, mbikëqyrësi do të thotë:



Tani, hapni fletën e përgjigjeve në faqen 6. Nëse po përdorni fletë përgjigjesh me shkronja të mëdha, hapeni në faqen 30. Në pjesën e pasme të librit të esesë, gjeni Kodi i esesë. Kopjojeni ekzaktësisht "Essay Code" (Kodi i esesë) që gjendet në pjesën e pasme të librit të testimit, në fushën e fletës së përgjigjeve dhe mbushni rrethin e alternativës përkatëse. Kjo fushë duhet të plotësohet saktë, ndryshe rezultati i esesë mund të mos llogaritet.

Mbajeni fletën e përgjigjeve të hapur në këtë faqe dhe merrni disa minuta kohë për të lexuar deklaratën në lidhje me përdorimin e esesë suaj, më pas vendosni nëse dëshironi ose jo ta shënoni rrethin (ose katrorin). Kur ta keni mbaruar së lexuari, ju lutem ngrini kokën lart.

Kur të gjithë studentët të kenë marrë librin e esesë, mbikëqyrësi do të thotë:



Pasi të fillojmë, do të keni 50 minuta kohë të punoni me esenë SAT. Mund të mbani shënime dhe të planifikoni esenë tuaj në faqen e planifikimit pa vija, por çdo gjë e shkruar aty nuk do të merret parasysh për rezultatin. Kur të jeni gati, filloni të shkruani esenë në fletën e parë të vijëzuar ku shkruhet "Begin Your Essay Here" (Fillo esenë këtu). Duhet të shkruani esenë tuaj në faqet përkatëse të fletës së përgjigjeve dhe brenda kufijve të shënuar. Ndaloni së shkruari te fjala "STOP" (NDAL) në fletën e fundit të vijëzuar, sepse asgjë e shkruar poshtë saj nuk do të merret parasysh për rezultatin. Nuk lejohen faqe shtesë. Esenë tuaj duhet ta shkruani duke përdorur një laps numër 2. Nëse nuk përdorni laps numër 2, eseja juaj do të duket bosh. Nëse e lini esenë bosh, do të merrni rezultat zero për esenë.

Pastaj mbikëqyrësi do të thotë:



Lexoni udhëzimet në kapakun e librit të esesë dhe pastaj hapni librin e esesë dhe filloni punën. Koha fillon tani.

Pasi të kenë kaluar 25 minuta, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Keni 25 minuta të mbetura në këtë pjesë.

Pas 45 minutash, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Keni 5 minuta të mbetura në këtë pjesë.

Pas saktësisht 50 minutash, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Ndaloni punën dhe lini lapsin poshtë. Mbylleni fletën e përgjigjeve dhe librin e esesë. Vendoseni librin e përgjigjeve të kthyer në anën e përparme, pranë librit të esesë.

Për të gjithë studentët, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Testi përfundoi. Suksese! Ju lutem, qëndroni ulur në qetësi ndërkohë që mbledh dhe numëroj librat e esesë.

3.2.1 Udhëzime për librin e esesë



Më poshtë keni një përkthim të udhëzimeve që gjenden në pjesën e përparme të librit të esesë.

UDHËZIME

Eseja ju jep mundësinë të tregoni sa mirë mund të lexoni dhe kuptoni një fragment dhe të shkruani një ese duke analizuar fragmentin. Në esenë tuaj, duhet të tregoni se e keni lexuar fragmentin me kujdes, të bëni një analizë të qartë dhe logjike, dhe të përdorni gjuhën me saktësi.

Eseja duhet të shkruhet mbi rreshtat që gjenden në broshurën e përgjigjeve; përveç faqes së planifikimit të broshurës së përgjigjeve, nuk do të merrni letër tjetër për të shkruar. Do të keni hapësirë të mjaftueshme nëse shkruani në çdo rresht, shmangni bordurat tepër të gjera, dhe mbani shkrimin e dorës me madhësi të arsyeshme. Mos harroni se njerëzit që nuk e njohin shkrimin tuaj do të lexojnë atë që shkruani. Përpiqni të shkruani ose printoni në mënyrë të tillë që ajo që shkruani të jetë e lexueshme për të tjerët.

Keni 50 minuta kohë për të lexuar fragmentin dhe për të shkruar një ese në përgjigje të kërkesës që gjendet brenda kësaj broshure.

KY LIBËR PROVIMI NUK DUHET TË MERRET JASHTË SALLËS.
NDALOHET RIPRODHIMI OSE PËRDORIMI I PAAUTORIZUAR
I ÇFARËDO PJESE TË KËTIJ LIBRI PROVIMI.

PËRKUJTUES

- Mos e shkruani esenë tuaj brenda kësaj broshure. Do të vlerësohet vetëm ajo që shkruani në faqet me vija në broshurën e përgjigjeve.
- Nuk do të vlerësohen esetë që janë jashtë teme

3.3 Pas përfundimit të testimit

Për të gjithë studentët, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Tani dëgjoni këtë informacion të rëndësishëm. Nëse doni të anuloni rezultatet tuaja para se të largoheni, më kërkoni një Request to Cancel Test Scores form (Formular kërkesë për të anuluar rezultatet e provimit), të cilin duhet ta plotësoni para se të largoheni nga dhoma. Për të anuluar rezultatet tuaja më vonë, duhet të njoftoni College Board me shkrim jo më vonë se ora 11:59 e mbrëmjes. me orën lindore në ditën e katërt të javës duke filluar nga sot.

Dërgoni kërkesën e firmosur të anulimit me postë brenda një dite ose me faks. Nuk mundeni t'i anuloni rezultatet me një mesazh email ose telefon.

Për të gjithë studentët, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Nëse keni ende të dhëna të paplotësuara që nuk kanë të bëjnë me pyetjet e testit, duke përfshirë çdo ndryshim që dëshironi të bëni në fushën 14, ku mund të zgjidhni fakultetet apo programet e bursave të cilëve doni t'ju dërgohen rezultatet, hapini fletët e përgjigjeve në faqen 2 (ose në faqen 5 për fletët me kuadrate të zmadhuara). Qëndroni ulur në qetësi dhe mos shkruani asgjë në fletën e përgjigjes ndërkohë që largohen studentët e tjerë. Pas pak minutash do të vij t'ju ndihmoj për të plotësuar fletët e përgjigjeve.

3.4 Plotësimi i fletëve të përgjigjeve



Nëse i keni plotësuar të dhënat personale në fletën e përgjigjeve, mbajini mbyllur ato. mbikëqyrësi do të kalojë në pjesën “Mbledhja e fletëve të përgjigjeve” dhe do të mbledhë fletët e përgjigjeve. Në të kundërt, qëndroni ulur në qetësi ndërkohë që largohen studentët e tjerë.

Për të gjithë studentët, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Ndiqni në broshurën “Student Answer Sheet Instructions” (Udhëzimet e fletës së përgjigjeve për studentin) ndërkohë që ju lexoj udhëzimet.

Për fushat 9-13, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Kthehuni në faqen 2 (ose faqen 4 në fletët e përgjigjeve me kuadrate të zmadhuara alternativash) dhe plotësoni adresën tuaj në fushat 9–12. Lëreni fushën 13 bosh. Ngrini dorën nëse keni pyetje. Ngrini kokën lart kur të keni mbaruar.

Për fushën 14, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Gjeneroni fushën 14 në faqen 2 të fletës suaj të përgjigjeve (ose në faqen 5 të fletëve të përgjigjeve me kuadrate të zmadhuara). Kur e bëni testin SAT gjatë “SAT School Day” (Dita e testimit SAT në shkollë), keni të drejtën të dërgoni, pa pagesë, rezultatet tuaja deri në 4 fakultete ose programe bursash. Plotësimi i këtij seksioni është opsional. Fakultetet dhe universitetet janë gjithmonë në pritje të rezultateve nga studentët, edhe nëse ju nuk jeni gati për të aplikuar.

Gjeni “Score Reporting Code List” (Lista e kodeve të raportimit të rezultateve) në broshurën “*Student Answer Sheet Instructions*” (Udhëzimet e fletës së përgjigjeve për studentin). Përdoreni këtë listë për të gjetur numrin 4-shifror për shkollat apo programet e bursave të cilëve dëshironi t’u dërgoni rezultatet tuaja. Fakultetet dhe universitetet e SHBA-së janë renditur fillimisht sipas shtetit dhe më pas alfabetikisht sipas emrit. Më pas vijojnë institucionet e territorit të SHBA-së, të ndjekura nga ato ndërkombëtare. Në listën e fundit të këtij dokumenti tregohen programet e bursave të renditura sipas shtetit ose vendit, në rend alfabetik.

Për çdo vend ku dëshironi të dërgoni rezultatet tuaja, kopjoni 4 shifrat nëpër kuti dhe mbushni rrathët e alternativave përkatëse (nëse po përdorni një fletë përgjigjeje me kuadrate të zmadhuara, shkruajini shifrat sa më qartë të jetë e mundur). Më thoni nëse keni pyetje.

Ngrini kokën lart kur të keni mbaruar.

Tani mbikëqyrësi do të thotë:

-  Nëse nuk keni të dhëna të tjera për të përfshirë në fletën e përgjigjeve, mbylleni “*Student Answer Sheet Instructions*” (Udhëzimet e fletës së përgjigjeve për studentin) si dhe fletën e përgjigjeve dhe kthejeni atë në anën e përparme. Unë do të ndihmoj studentët e tjerë për të filluar plotësimin e pjesës së mbetur të fletës së përgjigjeve dhe ndërkohë që ata do të jenë duke punuar, do të largoj të gjithë studentët që e kanë përfunduar testimin.

Nëse i keni plotësuar fushat 15–38 në fletën e përgjigjeve, kthehuni në pjesën “Mbledhja e fletëve të përgjigjeve” dhe prisni ndërkohë që mbikëqyrësi u lexon tekstet vijuese studentëve të tjerë.

Për fushën 15, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Kaloni në faqen 3 (ose qëndroni në faqen 5 nëse po përdorni fletë përgjigjesh me shkronja të mëdha). Fusha 15 ju pyet nëse doni të regjistroheni për Student Search Service (Shërbimi kërkimit të studentit). Ky shërbim mund t’ju ndihmojë të lidheni me mundësi të ndryshme. Nëse i përgjigjeni me “Po” këtij shërbimi, kjo u mundëson fakulteteve, programeve të bursave dhe programeve të tjera arsimore që t’ju dërgojnë informacion në lidhje me mundësitë e arsimimit dhe mbështetjes financiare që ata ofrojnë. Fakultetet, universitetet, programe e bursave dhe programet e tjera arsimore që e kërkojnë këtë, do të marrin të dhënat tuaja në fletën e përgjigjeve, por nuk do të marrin rezultatet konkrete të testit apo numrin tuaj të telefonit. Në pjesën *Udhëzime për fletën e përgjigjeve të studentit* ka më shumë informacion rreth shërbimit të kërkimit të studentit. Nëse nuk i përgjigjeni dhe më parë keni zgjedhur të merrni pjesë në këtë shërbim, College Board do të vazhdojë të japë informacionet tuaja. Ju lutem bëni zgjedhjen tuaj.

Për fushën 16, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Nëse doni të merrni informacione nga College Board me email, përfshirë këtu të dhëna mbi rezultatet tuaja pasi ato të vihen në dispozicion në internet, shkruani adresën tuaj të email-it dhe plotësoni flluskat përkatëse në kutinë 16. Kjo është në faqen 6 nëse po përdorni fletë përgjigjesh me kuadrate të zmadhuara. Tregoni në pjesën e sipërme të fushës nëse kjo është adresa juaj e email-it apo adresa e një prindi apo kujdestari. Nëse jepni adresën personale të emailit dhe jeni regjistruar në “Student Search Service” (Shërbimi i kërkimit të studentëve) në fushën 15, ju mund të merrni informacion edhe nga fakultetet që janë dërguar në adresën tuaj.

Për fushën 17, mbikëqyrësi do t'ju thotë të gjithë studentëve:

-  Fusha 17 ju pyet për numrin celular të SHBA-së. Pranohen vetëm numrat celularë të SHBA-së. Ju lutem rishikoni dokumentin që ju dhashë për Mobile Opt-In Policies (Politikat e regjistrimit të celularit) para se të vendosni të jepni numrin tuaj. Do të keni mundësi ta merrni këtë dokument me vete në shtëpi për referencë në të ardhmen. Duke dhënë numrin tuaj, ju pranoni të merrni mesazhe nga College Board rreth SAT, të merrni pjesë në sondazhe studimore, dhe të merrni informacione falas mbi shërbimet e planifikimit për kolegji. Zbatohen tarifat standarde për mesazhet tekst. Mund të zgjidhni të përjashtoheni në çfarëdo kohe. College Board nuk do të ndajë numrin tuaj të telefonit me organizata të tjera.

Kjo fushë është opsionale. Nëse i pranoni këto kushte, vendosni numrin tuaj të telefonit dhe mbushni rrathët përkatës të alternativave. Ju lutem ngrini kokën kur të keni mbaruar.

Kur të gjithë të jenë gati, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Tani do të plotësojmë pjesën tjetër të pyetjeve jo të lidhura me testin, të cilat kërkojnë të dhëna të tjera rreth jush, arsimimit dhe aktiviteteve e interesave tuaja jashtëshkollore.

Plotësimi i këtij informacioni opsional paraqet disa avantazhe. Nëse jeni regjistruar në “Student Search Service” (Shërbimi i kërkimit të studentëve), ky informacion u jepet fakulteteve, universiteteve dhe ofruesve të bursave dhe përdoret për identifikimin e studentëve të cilët mund të jenë të interesuar për mundësitë që ofrohen. Megjithatë, është e rëndësishme të dini gjithashtu se “College Board” mund ta përdorë këtë informacion dhe t’ua japë atë palëve të treta për përdorime të mëtejshme, si p.sh për studime.

Këtë seksion mund të zgjidhni ta plotësoni ose ta lini bosh. Nëse prindi apo kujdestari juaj ju ka porositur të mos plotësoni të dhëna opsionale, qëndroni ulur në qetësi ndërkohë që të tjerët përfundojnë këtë pjesë. Mos plotësoni asnjë fushë që ju kërkon të dhëna të cilat prindi apo kujdestari juaj ju ka porositur të mos i jepni.

Udhëzimet në lidhje me mënyrën e plotësimit të këtyre fushave i gjeni në broshurën “Student Answer Sheet Instructions” (Udhëzimet e fletës së përgjigjeve për studentin), duke nisur nga faqja 3. Ndiqni udhëzimet për të plotësuar fushat 18–21. Më pas në kapakun e brendshëm të pasmë të fletës së përgjigjeve (ose në faqen 8 në fletën e përgjigjeve me kuadrate të zmadhuara) për të plotësuar fushat 22–38. Ngrini dorën nëse keni pyetje.

Kur të keni mbaruar, mbylleni broshurën “Student Answer Sheet Instructions” (Udhëzimet e fletës së përgjigjeve për studentin) dhe vendoseni atë pranë fletës së përgjigjeve mbi bankë. Vendoseni fletën e përgjigjeve mbi tavolinë të kthyer në anën e përparme. Ju lutem, prisni në qetësi deri sa të mbarojnë të tjerët.

3.5 Mbledhja e fletëve të përgjigjeve

Për studentët që janë gati të largohen, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Mos harroni, në asnjë rrethanë nuk duhet të merrni me vete pyetjet e provimit nga dhoma e provimit, nuk duhet t’ia jepni dikujt tjetër, apo t’i diskutoni me dikë tjetër me çfarëdo forme, duke përfshirë email, mesazhe, ose internet.

Për studentët që e kanë bërë esenë SAT, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Gjithashtu, nuk lejohet të diskutoni ose shkëmbeni pyetjet e esesë së sotme derisa ajo të publikohet në internet.

Nëse studentët duhet të mbledhin sendet e tyre personale, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Ky administrim provimi tani ka mbaruar. Ndërsa përgatiteni për t'u larguar, ju lutem afrohuni dhe merrni sendet personale që ju mora më parë. Pasi të keni marrë të gjitha sendet tuaja, mund të dilni nga dhoma me qetësi. Ju lutem, kini parasysh se studentët në dhomat e tjera mund të jenë ende duke bërë provim. Urime përsëri, dhe faleminderit për pjesëmarrjen dhe për gjithë punën tuaj të vështirë.

Nëse studentët i kanë të gjitha sendet personale, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Ky administrim provimi tani ka mbaruar. Merrni sendet tuaja dhe dilni nga dhoma me qetësi. Ju lutem, kini parasysh se studentët në dhomat e tjera mund të jenë ende duke bërë provim. Urime përsëri, dhe faleminderit për pjesëmarrjen dhe për gjithë punën tuaj të vështirë.

4 Teksti standard i SAT për sallat me studentë të kombinuar: Testi i matematikës me makinë llogaritëse dhe eseja e SAT

4.1 Seksioni 4—Testi i matematikës – Me makinë llogaritëse



*Koha standarde për pjesën 4 është **55 minuta**. Nëse po bëni provimin me një lehtësi të miratuar, koha dhe pushimet mund të jenë ndryshe. Dëgjojini me kujdes komunikimet që ju lexon mbikëqyrësi.*

Përkthimi i udhëzimeve të librit të provimit shfaqet pas udhëzimeve të përkthyer me gojë.

Kur të gjithë studentët të jenë gati, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Pasi të fillojmë, do të keni 55 minuta kohë të punoni me pjesën 4, testin e matematikës me makinë llogaritëse.

Mund të përdorni një makinë llogaritëse për këtë pjesë. Ju lutem nxirrni makinën llogaritëse tani dhe vendoseni në mes të bankës.

Kur të përdorni makinën llogaritëse, ndiqni këto udhëzime:

- Mbajeni mbi bankë ose mbajeni në mënyrë të tillë që studentët e tjerë të mos shohin dot punën tuaj.
- Mos e ndani ose mos e shkëmbeni makinën llogaritëse.
- Nëse keni marrë makinë llogaritëse ose bateri rezervë, mbajini në dysHEME poshtë bankës tuaj.
- Nëse makina juaj llogaritëse prishet dhe keni bateri ose makinë llogaritëse rezervë, ngrini dorën. Do të shikoj nëse mjeti juaj zëvendës është i pranueshëm. Nëse nuk keni rezervë, vazhdoni me provimin. Të gjitha pyetjeve të matematikës mund t'u jepet përgjigje edhe pa makinë llogaritëse.

Udhëzimet në lidhje me mënyrën e paraqitjes së përgjigjeve për pyetjet me emërtimin “Student-Produced Responses” (Përgjigjet e studentit), i gjeni në librin e testimit.

Përgjigjet e këtyre pyetjeve mund të përmbajnë deri në 4 karaktere. Sigurohuni të shënoni përgjigjet tuaja në hapësirat me numra që përkasin me pyetjet e provimit me numra në pjesën 4.

Nëse mbaroni para se të njoftohet mbarimi i kohës, mund të kontrolloni punën tuaj në këtë pjesë, por nuk lejohet të kaloni në asnjë pjesë tjetër.

Ju lutem hapni librin e provimit dhe nxirrni fletën e përgjigjeve. Mbajeni fletën e përgjigjeve dhe librin e provimit të shtrirë mbi bankë. Gjeni pjesën 4 në fletën e përgjigjeve. Tani, kaloni në pjesën 4 të librit të provimit, lexoni udhëzimet dhe filloni punën. Koha fillon tani.

Pas 25 minutash, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Keni 30 minuta të mbetura në këtë pjesë.

Pas 50 minutash, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Keni 5 minuta të mbetura në këtë pjesë.

Pas saktësisht 55 minutash, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Ndaloni punën dhe lini lapsin poshtë. Mbylleni librin e provimit dhe fletën e përgjigjeve. Vendoseni fletën e përgjigjeve ngjitur me librin e provimit.

Tani mbikëqyrësi do të thotë:

-  Para se të mbledh materialet e testit, ktheheni përmbys fletën e përgjigjeve (ose kthehuni në faqen 16 nëse po përdorni fletë përgjigjesh me kuadrate të zmadhuara) dhe verifikoni nëse e keni plotësuar kodin e formularit në fushën A. Ky kod është i nevojshëm për llogaritjen e rezultatit të testit tuaj.

Verifikoni gjithashtu nëse i keni plotësuar fushat B–E. Ju lutem, ngrini dorën nëse ju duhet ndihmë për plotësimin e ndonjë fushe.

Pasi të mbledhë dhe numërojë librat e testimit, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Nëse keni për të bërë esenë, vendoseni makinën llogaritëse nën bankë, ndërsa fletën e përgjigjeve mbi bankë të kthyer në anën e pasme. Nëse nuk keni për të bërë esenë, testi përfundoi. Suksese! Vendoseni fletën e përgjigjeve mbi bankë të kthyer në anën e përparme në mënyrë që ta kontrolloj kur t’i mbledh.

Qëndroni të gjithë ulur në qetësi sa të jap udhëzimet dhe të mbledh materialet e studentëve që po largohen.

Për të gjithë studentët, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Tani dëgjoni këtë informacion të rëndësishëm. Nëse doni të anuloni rezultatet tuaja para se të largoheni, më kërkoni Request to Cancel Test Scores form (Formular kërkesë për të anuluar rezultatet e provimit), të cilin duhet ta plotësoni para se të largoheni nga dhoma. Për të anuluar rezultatet tuaja më vonë, duhet të njoftoni College Board me shkrim jo më vonë se ora 11:59 e mbrëmjes. me orën lindore në ditën e katërt të javës duke filluar nga sot.

Dërgoni kërkesën e firmosur të anulimit me postë brenda një dite ose me faks. Nuk mundeni t'i anuloni rezultatet me një mesazh email ose telefon.

Për të gjithë studentët, mbikëqyrësi do të thotë:



Nëse mendoni se duhet të bëni ndryshime në fushën 14 të fletës së përgjigjeve, ku zgjidhen fakultetet dhe programet e bursave të cilëve doni t'ju dërgohen rezultatet, ngrini dorën.

4.1.1 Seksioni 4 Udhëzimet në librin e testimit



Më poshtë keni një përkthim të udhëzimeve që gjenden në fillim të pjesës 4 të librit të provimit.

55 MINUTA, 38 PYETJE (KOHA STANDARDE)

Kthehuni te pjesa 4 në fletën e përgjigjeve për t'iu përgjigjur pyetjeve në këtë pjesë.


UDHËZIME

Për pyetjet 1-30, zgjidhni çdo problem, zgjidhni përgjigjen më të mirë nga alternativat e dhëna dhe mbushni filluskën përkatëse në fletën e përgjigjeve. Për pyetjet 31-38, zgjidhni problemin dhe vendosni përgjigjen tuaj në tabelë në fletën e përgjigjeve. Ju lutem shikoni udhëzimet para pyetjes 22 se si të vendosni përgjigjet tuaja në tabelë. Mund të përdorni çdo hapësirë në dispozicion në librin e provimit për shënime personale.


SHËNIME

1. Lejohet përdorimi i makinës llogaritëse.
2. Të gjitha ndryshoret dhe shprehjet e përdorura tregojnë numra realë përveç nëse tregohet ndryshe.
3. Figurat e dhëna në këtë provim janë vizatuar në raporte proporcionale përveç nëse tregohet ndryshe.
4. Të gjitha figurat janë vendosur në plan të rrafshët përveç nëse tregohet ndryshe.
5. Përveç nëse tregohet ndryshe, integrali i një funksioni të dhënë f është grupi i të gjithë numrave realë x për të cilët $f(x)$ është një numër real.


REFERENCE




$$A = \pi r^2$$
$$C = 2\pi r$$





$$A = \ell w$$




$$A = \frac{1}{2}bh$$




$$c^2 = a^2 + b^2$$



Trekëndësja kënddrejtë
të posaçëm




$$V = \ell wh$$




$$V = \pi r^2 h$$



$$V = \frac{4}{3}\pi r^3$$



$$V = \frac{1}{3}\pi r^2 h$$



$$V = \frac{1}{3}\ell wh$$

Numri i gradëve të harkut në një rreth është 360.

Numri i radianëve të harkut në një rreth është 2π .

Shuma e matjeve në gradë e këndeve të një trekëndëshi është 180.

UDHËZIME

Për pyetjet 31-38, zgjidhni problemin dhe vendosni përgjigjen tuaj në tabelën e fletës së përgjigjeve, siç përshkruhet më poshtë

1. Megjithëse nuk është e detyrueshme, sugjerohet që përgjigjja të shkruhet në kutitë në pjesën e sipërme të kolonave për t'ju ndihmuar t'i mbushni saktë rrathët e alternativave. Do merrni pikë vetëm nëse flluskat janë mbushur saktë.
2. Shënoni jo më shumë se një flluskë në çdo kolonë.
3. Asnjë pyetje nuk ka përgjigje negative.
4. Disa probleme mund të kenë më shumë se një përgjigje të saktë. Në këto raste, shënoni vetëm një përgjigje.
5. **Numrat e përzierë** të tillë si $3\frac{1}{2}$ duhet të paraqiten si 3.5 ose $7/2$. (Nëse forma

3	1	/	2
	/		

e paraqitjes në tabelë është

numri do të interpretohet si $\frac{31}{2}$, jo $3\frac{1}{2}$.)

6. **Përgjigjet dhjetore:** Nëse merrni një përgjigje dhjetore me më shumë shifra nga sa mund të mbajë tabela, mund të rumbullakoset ose shkurtohet, por duhet të mbushë të gjithë tabelën.

Përgjigjja: $\frac{7}{12}$

Shkruajeni
përgjigjen →
nëpër kuti.

7	/	1	2
*	*	/	*
	0	0	0
1	1		1
2	2	2	
3	3	3	3
4	4	4	4
5	5	5	5
6	6	6	6
	7	7	7
8	8	8	8
9	9	9	9

← Vija e
thyesës

Vendosni
në tabelë
rezultatit.

Përgjigjja: 2.5

	2	.	5
•	/	/	
	0	0	0
1	1	1	1
2		2	2
3	3	3	3
4	4	4	4
5	5	5	
6	6	6	6
7	7	7	7
8	8	8	8
9	9	9	9

Pika
— dhjetore

Mënyrat e pranueshme të paraqitjes së $\frac{2}{3}$ janë:

	2	/	3
	/		
	.	.	.
	0	0	0
1	1	1	1
2		2	2
3	3	3	
4	4	4	4
5	5	5	5
6	6	6	6
7	7	7	7
8	8	8	8

.	6	6	6
	/	/	
	.	.	.
	0	0	0
1	1	1	1
2	2	2	2
3	3	3	3
4	4	4	4
5	5	5	5
6			
7	7	7	7
8	8	8	8

.	6	6	7
			
			
			
			
			
			
			
			
			
			
			

Përgjigjja: 201 – secili nga pozicionet është i saktë

	2	0	1
	/	/	
○	○	○	○
	0		0
1	1	1	
2		2	2
3	3	3	3

2	0	1	
	/	/	
○	○	○	○
	●	0	0
1	1	●	1
●	2	2	2
3	3	3	3

SHËNIM:
Mund t'i filloni
përgjigjet tuaja në
cilëndo kolonë nëse
jua lejon hapësira.
Kolonat që nuk ju
duhet t'i përdorni
duhet të lihen bosh.

4.2 Plotësimi i marrësve të rezultateve

Nëse i keni plotësuar të dhënat personale në fletën e përgjigjeve, mbikëqyrësi do t'ju marrë fletën e përgjigjeve dhe do të kalojë në pjesën "Mbledhja e fletëve të përgjigjeve".

Nëse nuk keni plotësuar informacionet personale në fletën e përgjigjeve, ose nëse informacionet tuaja personale janë plotësuar por doni të ndryshoni zgjedhjet se ku t'i dërgoni rezultatet në fushën 14, mbikëqyrësi do t'ju kërkojë të rrini ulur me qetësi ndërkohë që largohen studentët e tjerë.

Për të gjithë studentët, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Për të ndryshuar fakultetet dhe programet e bursave të cilëve do t'u dërgoni rezultatet, hapni fletën e përgjigjeve në faqen 2 (ose në faqen 5 për fletët e përgjigjeve me kuadrate të zmadhuara). Nëse nuk keni për të bërë ndryshime, qëndroni ulur në qetësi dhe mbajeni mbyllur fletën e përgjigjeve.

Për të gjithë studentët, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Ndiqni në broshurën "Student Answer Sheet Instructions" (Udhëzimet e fletës së përgjigjeve për studentin) ndërkohë që ju lexoj udhëzimet.

Për fushën 14, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Gjeneroni fushën 14 në faqen 2 të fletës suaj të përgjigjeve (ose në faqen 5 të fletëve të përgjigjeve me kuadrate të zmadhuara). Kur e bëni testin SAT gjatë "SAT School Day" (Dita e testimit SAT në shkollë), keni të drejtën të dërgoni, pa pagesë, rezultatet tuaja deri në 4 fakultete ose programe bursash. Plotësimi i këtij seksioni është opsional. Fakultetet dhe universitetet janë gjithmonë në pritje të rezultateve nga studentët, edhe nëse ju nuk jeni gati për të aplikuar.

Gjeni "Score Reporting Code List" (Lista e kodeve të raportimit të rezultateve) në broshurën "Student Answer Sheet Instructions" (Udhëzimet e fletës së përgjigjeve për studentin). Përdoreni këtë listë për të gjetur numrin 4-shifror për shkollat apo programet e bursave të cilëve dëshironi t'u dërgoni rezultatet tuaja. Fakultetet dhe universitetet e SHBA-së janë renditur fillimisht sipas shtetit dhe më pas alfabetikisht sipas emrit. Më pas vijojnë institucionet e territorit të SHBA-së, të ndjekura nga ato ndërkombëtare. Në listën e fundit të këtij dokumenti tregohen programet e bursave të renditura sipas shtetit ose vendit, në rend alfabetik.

Për çdo vend ku dëshironi të dërgoni rezultatet tuaja, kopjoni 4 shifrat nëpër kuti dhe mbushni rrathët e alternativave përkatëse (nëse po përdorni një fletë përgjigjeje me kuadrate të zmadhuara, shkruajini shifrat sa më qartë të jetë e mundur). Më thoni nëse keni pyetje.

Ngrini kokën lart kur të keni mbaruar.

Tani mbikëqyrësi do të thotë:

-  Mbyllni "Student Answer Sheet Instructions" (Udhëzimet e fletës së përgjigjeve për studentin) dhe fletët e përgjigjeve. Nëse po prisni për të bërë esenë, sigurohuni që fleta e përgjigjeve të jetë mbi tavolinë e kthyer në anën e pasme. Nëse e keni përfunduar testimin, kthejeni fletën e përgjigjeve në anën e përparme në mënyrë që ta kontrolloj kur t'i mbledh.

4.3 Mbledhja e fletëve të përgjigjeve

Për studentët që janë gati të largohen, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Mos harroni, në asnjë rrethanë nuk duhet të merrni me vete pyetjet e provimit nga dhoma e provimit, nuk duhet t'ia jepni dikujt tjetër, apo t'i diskutoni me dikë tjetër me çfarëdo forme, duke përfshirë email, mesazhe, ose internet.

Nëse studentët duhet të mbledhin sendet e tyre personale, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Ky administrim provimi tani ka mbaruar. Ndërsa përgatiteni për t'u larguar, ju lutem afrohuni dhe merrni sendet personale që ju mora më parë. Pasi të keni marrë të gjitha sendet tuaja, mund të dilni nga dhoma me qetësi. Ju lutem, kini parasysh se studentët në dhomat e tjera mund të jenë ende duke bërë provim. Urime përsëri, dhe faleminderit për pjesëmarrjen dhe për gjithë punën tuaj të vështirë.

Nëse studentët i kanë të gjitha sendet personale, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Ky administrim provimi tani ka mbaruar. Merrni sendet tuaja dhe dilni nga dhoma me qetësi. Ju lutem, kini parasysh se studentët në dhomat e tjera mund të jenë ende duke bërë provim. Urime përsëri, dhe faleminderit për pjesëmarrjen dhe për gjithë punën tuaj të vështirë.

4.4 Eseja SAT



*Koha standarde për pjesën Eseja SAT është **50 minuta**. Nëse po bëni provimin me një lehtësi të miratuar, koha dhe pushimet mund të jenë ndryshe. Dëgjojeni me kujdes komunikimet që ju lexon mbikëqyrësi*

Një përkthim i deklaratës për përdorimin e esesë suaj (në fletën e përgjigjeve) dhe i udhëzimeve të librit të esesë shfaqet pas udhëzimeve të përkthyer me gojë.

Për të gjithë studentët, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Tani do t'i jap një libër eseje secilit prej jush. Mos e hapni librin e esesë derisa t'ju them unë.

Pastaj mbikëqyrësi do të thotë:

-  Kur të merrni librin e esesë, kthejeni mbrapa dhe shkruani me shkronja shtypi mbiemrin, emrin dhe inicialin e emrit të mesëm nëse keni. Më pas shkruani numrin e kodit të shkollës _____, emrin e shkollës _____ dhe numrin (ose emrin) e kësaj sale _____.

Pastaj, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Tani, hapni fletën e përgjigjeve në faqen 6. Nëse po përdorni fletë përgjigjesh me shkronja të mëdha, hapeni në faqen 30. Në pjesën e pasme të librit të esesë, gjeni Kodi i esesë. Kopjojeni ekzakhtësisht "Essay Code" (Kodi i esesë) që gjendet në pjesën e pasme të librit të testimit, në fushën e fletës së përgjigjeve dhe mbushni rrethin e alternativës përkatëse. Kjo fushë duhet të plotësohet saktë, ndryshe rezultati i esesë mund të mos llogaritet.

Mbajeni fletën e përgjigjeve të hapur në këtë faqe dhe merrni disa minuta kohë për të lexuar deklaratën në lidhje me përdorimin e esesë suaj, më pas vendosni nëse dëshironi ose jo ta shënoni rrethin (ose katrorin). Kur ta keni mbaruar së lexuari, ju lutem ngrini kokën lart.

Kur të gjithë studentët të kenë marrë librin e esesë, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Pasi të fillojmë, do të keni 50 minuta kohë të punoni me esenë SAT. Mund të mbani shënime dhe të planifikoni esenë tuaj në faqen e planifikimit pa vija, por çdo gjë e shkruar aty nuk do të merret parasysh për rezultatin. Kur të jeni gati, filloni të shkruani esenë në fletën e parë të vijëzuar ku shkruhet "Begin Your Essay Here" (Fillo esenë këtu). Duhet të shkruani esenë tuaj në faqet përkatëse të fletës së përgjigjeve dhe brenda kufijve të shënuar. Ndaloni së shkruari te fjala "STOP" (NDAL) në fletën e fundit të vijëzuar, sepse asgjë e shkruar poshtë saj nuk do të merret parasysh për rezultatin. Nuk lejohen faqe shtesë. Esenë tuaj duhet ta shkruani duke përdorur një laps numër 2. Nëse nuk përdorni laps numër 2, eseja juaj do të duket bosh. Nëse e lini esenë bosh, do të merrni rezultat zero për esenë.

Pastaj mbikëqyrësi do të thotë:

-  Lexoni udhëzimet në kapakun e librit të esesë dhe pastaj hapni librin e esesë dhe filloni punën. Koha fillon tani.

Pasi të kenë kaluar 25 minuta, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Keni 25 minuta të mbetura në këtë pjesë.

Pas 45 minutash, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Keni 5 minuta të mbetura në këtë pjesë.

Pas saktësisht 50 minutash, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Ndaloni punën dhe lini lapsin poshtë. Mbylleni fletën e përgjigjeve dhe librin e esesë. Vendoseni librin e përgjigjeve të kthyer në anën e përparme, pranë librit të esesë.

Për të gjithë studentët, mbikëqyrësi do të thotë:

-  Testi përfundoi. Suksese! Ju lutem, qëndroni ulur në qetësi ndërkohë që mbledh dhe numëroj librat e esesë.

4.4.1 Udhëzime për librin e esesë



Më poshtë keni një përkthim të udhëzimeve që gjenden në pjesën e përparme të librit të esesë.

UDHËZIME

Eseja ju jep mundësinë të tregoni sa mirë mund të lexoni dhe kuptoni një fragment dhe të shkruani një ese duke analizuar fragmentin. Në esenë tuaj, duhet të tregoni se e keni lexuar fragmentin me kujdes, të bëni një analizë të qartë dhe logjike, dhe të përdorni gjuhën me saktësi.

Eseja duhet të shkruhet mbi rreshtat që gjenden në broshurën e përgjigjeve; përveç faqes së planifikimit të broshurës së përgjigjeve, nuk do të merrni letër tjetër për të shkruar. Do të keni hapësirë të mjaftueshme nëse shkruani në çdo rresht, shmangni bordurat tepër të gjera, dhe mbani shkrimin e dorës me madhësi të arsyeshme. Mos harroni se njerëzit që nuk e njohin shkrimin tuaj do të lexojnë atë që shkruani. Përpiqni të shkruani ose printoni në mënyrë të tillë që ajo që shkruani të jetë e lexueshme për të tjerët.

Keni 50 minuta kohë për të lexuar fragmentin dhe për të shkruar një ese në përgjigje të kërkesës që gjendet brenda kësaj broshure.

KY LIBËR PROVIMI NUK DUHET TË MERRET JASHTË SALLËS.
NDALOHET RIPRODHIMI OSE PËRDORIMI I PAAUTORIZUAR I
ÇFARËDO PJESE TË KËTIJ LIBRI PROVIMI.

PËRKUJTTUES

- Mos e shkruani esenë tuaj brenda kësaj broshure. Do të vlerësohet vetëm ajo që shkruani në faqet me vija në broshurën e përgjigjeve.
- Nuk do të vlerësohen esetë që janë jashtë teme

4.5 Para se të largohen studentët

Kur të jenë marrë të gjitha materialet e studentëve, mbikëqyrësi do të thotë:

- Mos harroni, në asnjë rrethanë nuk duhet të merrni me vete pyetjet e provimit nga dhoma e provimit, nuk duhet t'ia jepni dikujt tjetër, apo t'i diskutoni me dikë tjetër me çfarëdo forme, duke përfshirë email, mesazhe, ose internet.

Për studentët që e kanë bërë esenë SAT, mbikëqyrësi do të thotë:

- Gjithashtu, nuk lejohet të diskutoni ose shkëmbeni pyetjet e esesë së sotme derisa ajo të publikohet në internet.

Nëse studentët duhet të mbledhin sendet e tyre personale, mbikëqyrësi do të thotë:

- Ky administrim provimi tani ka mbaruar. Ndërsa përgatiteni për t'u larguar, ju lutem afrohuni dhe merrni sendet personale që ju mora më parë. Pasi të keni marrë të gjitha sendet tuaja, mund të dilni nga dhoma me qetësi. Ju lutem, kini parasysh se studentët në dhomat e tjera mund të jenë ende duke bërë provim. Urime përsëri, dhe faleminderit për pjesëmarrjen dhe për gjithë punën tuaj të vështirë.

Nëse studentët i kanë të gjitha sendet personale, mbikëqyrësi do të thotë:

- Ky administrim provimi tani ka mbaruar. Merrni sendet tuaja dhe dilni nga dhoma me qetësi. Ju lutem, kini parasysh se studentët në dhomat e tjera mund të jenë ende duke bërë provim. Urime përsëri, dhe faleminderit për pjesëmarrjen dhe për gjithë punën tuaj të vështirë.